



Në bazë të nenit 103 dhe 149 të Ligjit për arsim të lartë të RMV-së („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr. 82/18), Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të lartë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr. 76/2020 dhe 116/20), Statutit të Universitetit të Tetovës, Rregullores për studimet e ciklit të parë, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për numrin e studentëve të cilët regjistrohen në institucionet e arsimit të lartë në vitin e parë të studimeve në vitin akademik 2026/27 nr. 57-5391/7 të datës 14.07.2026 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr. 160/26), Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për kuota plotësuese për regjistrimin e studentëve të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në institucionet e arsimit të lartë në vitin e parë të studimeve të vitit akademik 2026/27 nr. 57-4996/6 të datës 14.07.2026 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr. 160/26) dhe Vendimit të Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës nr. 02-604/1 më 01.04.2026, Universiteti i Tetovës shpall:

K O N K U R S

për regjistrimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve në programet studimore të Universitetit të Tetovës në vitin akademik 2026/27

I. Numri i studentëve:

Në fakultetet e Universitetit të Tetovës, në vitin e parë të studimeve të ciklit parë në vitin akademik 2026/27, numri i studentëve që do të mund të regjistrohen është si në vijim:

FAKULTETI Programi studimor Drejtimi	Kohëzgjatja e studimeve		KUOTË SHTETËRORE 100 euro / semestër	KOOFINANCIM 200 euro / semestër	KORRESPONDENCË 200 euro / semestër	Gjithsej vende të lira
FAKULTETI FILOLOGJIK	Semestra	ECTS	105	55	55	215
Gjuhë dhe Letërsi Angleze	8	240	25	15	15	55
Gjuhë dhe Letërsi Frënge	8	240	10	5	5	20
Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	8	240	30	15	15	60
Gjuhë dhe Letërsi Maqedonase	8	240	20	10	10	40
Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	8	240	20	10	10	40
FAKULTETI JURIDIK	Semestra	ECTS	70	45	40	155
Gazetari dhe Media	8	240	10	5	5	20
Kriminalistikë	8	240	15	5	10	30
Studime Politike	8	240	5	5	5	15
Studimet e Drejtësisë	8	240	40	30	20	90
FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE	Semestra	ECTS	30	30	100	160
Kulturë Fizike dhe Shëndetësi	8	240	30	30		60
Trajner i Sportit - Basketboll	6	180			20	20
Trajner i Sportit - Futboll	6	180			20	20
Trajner i Sportit - Skijim	6	180			20	20
Trajner i Sportit - Sportet Mundëse	6	180			20	20
Trajner i Sportit - Volejbol	6	180			20	20
FAKULTETI I ARTEVE	Semestra	ECTS	77	47		124



Art Dramatik - Aktrim	8	240	6	4		10
Art Dramatik - Kinematografi	8	240	3	2		5
Art Dramatik - Montazh	8	240	3	2		5
Art Dramatik - Regji Filmi	8	240	3	2		5
Art Figurativ - Dizajn Grafik	8	240	8	5		13
Art Figurativ - Grafikë	8	240	4	2		6
Art Figurativ - Pedagogji Figurative	8	240	6	4		10
Art Figurativ - Pikturë	8	240	6	4		10
Art Figurativ - Skulpturë	8	240	4	2		6
Art Muzikor - drejtimi Muzikologji	8	240	5	3		8
Art Muzikor - Kompozim	8	240	5	3		8
Art Muzikor - Pedagogji Muzikore	8	240	10	5		15
Art Muzikor - Piano	8	240	3	2		5
Art Muzikor - Solo Këndim	8	240	5	3		8
Art Muzikor - Violë	8	240	3	2		5
Art Muzikor - Violinë	8	240	3	2		5
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE	Semestra	ECTS	475	180	5	660
Biokimi Analitike *	8	240	25	5		30
Biologji *	8	240	40	10		50
Biologji - Biokimi *	8	240	50	20		70
Biologji-Kimi	8	240	20	10		30
Ekologji *	8	240	15	5		20
Fizikë	8	240	15	5		20
Fizikë e Zbatuar	8	240	15	5		20
Fizikë-Kimi	8	240	15	5		20
Gjeografi	8	240	10	5	5	20
Informatikë *	8	240	40	10		50
Informatikë - drejtimi Informatikë Biznesi	8	240	30	10		40



Informatikë - Shkenca Kompjuterike *	8	240	60	40		100
Kimi	8	240	20	10		30
Kimi e Zbatuar *	8	240	20	10		30
Matematikë	8	240	40	10		50
Matematikë - drejtimi Matematikë Financiare	8	240	30	10		40
Matematikë e Zbatuar	8	240	30	10		40
FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA	Semestra	ECTS	150	90		240
Arkitekturë	10	300	20	20		40
Dizajn dhe Enterier në Arkitekturë	6	180	30	20		50
Inxhinieria e Komunikacionit-Transportit	8	240	20	10		30
Mekatronikë	8	240	30	10		40
Ndërtimtari	8	240	30	20		50
Ndërtimtari - Infrastrukturë Rrugore	8	240	20	10		30
FAKULTETI EKONOMIK	Semestra	ECTS	225	110	55	390
Ekonomi dhe Biznes	8	240	40	20	10	70
Financa dhe Kontabilitet	8	240	40	20	10	70
Investigim dhe Kontroll Financiar	8	240	50	20	10	80
Marketing dhe Menaxhment	8	240	30	20	10	60
Shpedicion dhe Sigurim	8	240	50	20	10	80
Turizëm dhe Hoteleri	8	240	15	10	5	30
FAKULTETI I ADMINISTRATËS SË BIZNESIT - KUMANOVË	Semestra	ECTS	40	20	25	85
Administratë Publike	8	240	10	5	5	20
Administrim Biznesi	8	240	15	10	10	35
Informatikë Afariste	8	240	15	5	10	30
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE	Semestra	ECTS	195	240	90	525
Farmaci *	10	300	30	30		60
Fizioterapi *	6	180	15	20	30	65
Infermieri *	6	180	35	60	30	125



Kozmetikë me Estetikë	6	180	20	10	10	40
Mami *	6	180	20	20	20	60
Mjekësi Dentare	10	300	35	50		85
Mjekësi e Përgjithshme *	12	360	40	50		90
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË	Semestra	ECTS	60	40	20	120
Agrobiznes	8	240	20	10	10	40
Mjekësi Veterinare	10	300	20	20		40
Prodhimtari Bimore	8	240	20	10	10	40
FAKULTETI PEDAGOGJIK	Semestra	ECTS	110	50	30	190
Edukim Parashkollor	8	240	15	5	10	30
Edukim Special dhe Rehabilitim	8	240	30	10		40
Logopedi	8	240	35	15		50
Mësim Klasor	8	240	15	10	10	35
Pedagogji Profesionale	8	240	15	10	10	35
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE DHE TË USHQYERIT	Semestra	ECTS	90	30	30	150
Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore	6	180	30	10	20	60
Nutricioni *	6	180	30	10	10	50
Teknologji Ushqimore *	8	240	30	10		40
FAKULTETI FILOZOFIK	Semestra	ECTS	70	50	30	150
Filologji Orientale - Gjuhë dhe Letërsi Arabe	8	240	10	5	5	20
Filologji Orientale - Gjuhë dhe Letërsi Turke	8	240	10	5	5	20
Filozofi	8	240	10	5	5	20
Histori	8	240	15	10	10	35
Psikologji	8	240	20	20		40
Sociologji	8	240	5	5	5	15
		Gjithsej	1697	987	480	3164

* Program studimor në proces të akreditimit



II. Kushtet dhe kriteret për regjistrim:

1. Të drejtë regjistrimi në studimet e ciklit të parë, kanë kandidatët që e kanë dhënë maturën shtetërore, maturën ndërkombëtare ose maturë profesionale/artistike.

2. Të drejtë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve, kanë edhe kandidatët me shkollim të mesëm katërvjeçar të cilët nuk kanë dhënë maturë shtetërore respektivisht e kanë përfunduar shkollimin e mesëm katërvjeçar para vitit akademik 2007/08 dhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në vitin shkollor 2019/20;

2.1 Në afatin e parë dhe të dytë të regjistrimit të drejtë aplikimi në programet studimore Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi Dentare dhe Farmaci kanë vetëm kandidatët të cilët e kanë kryer shkollimin e mesëm të mjekësisë ose gjimnaz.

2.2 Kandidatët me maturë profesionale/artistike kanë të drejtë regjistrimi vetëm në programet studimore në listën nr. 3.

3. Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt të financuar nga shteti dhe si studentë të rregullt me koofinancim të studimeve. Në studimet e ciklit të parë, mund të regjistrohen edhe studentë me korrespondencë, nëse këtë e mundëson programi studimor;

4. Në studimet e ciklit të parë të fakulteteve mund të regjistrohen edhe kandidatë të cilët kanë të kryer arsimim të lartë, në fakultetet e ngjashme dhe shkollat e larta. Këta kandidatë regjistrohen jashtë kuotës, më së shumti deri në **20%** nga numri i përgjithshëm i studentëve në fakultetin ose programin studimor të përcaktuar në Konkurs, sipas vendimit të Komisionit Universitar, me propozim të Komisionit të fakultetit për regjistrim. Kandidatët nga paragrafi i mëparshëm regjistrohen sipas suksesit nga arsimimi i mëparshëm, përveç në programet studimore për të cilat për shkak të specifikave nevojitet verifikim i talentit. Ngjashmërinë e vërtetojnë dhe e shpallin fakultetet. Kandidatët nga kjo pikë regjistrohen me koofinancim të studimeve, sikurse kandidatët nga kreu V i Konkursit;

5. Mënyra e seleksionimit të kandidatëve do të kryhet varësisht nga lloji i programeve studimore në të cilat konkurrojnë ata, edhe atë:

a) Programe studimore në të cilat seleksionimi i kandidatëve do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm;

b) Programe studimore në të cilat seleksionimi do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm dhe me kontrollim të talentit të kandidatëve. Kjo ka të bëjë me programet studimore me specifika të veçanta.

6. Kriter bazë për seleksionimin e kandidatëve për regjistrim të studimeve deridiplomike është suksesi i arritur në arsim të mesëm, vlerësimi i suksesit të studentëve shprehet me pikë:

a. Në programet studimore ku seleksionimi kryhet vetëm përmes suksesit të arsimit të mesëm, kandidatët mund të fitojnë më së shumti **100 pikë**, edhe atë: suksesi i përgjithshëm në të gjitha lëndët vlerësohet me **60%**, ndërsa suksesi i arritur në maturën shtetërore dhe në maturën profesionale vlerësohet me **40%**.

a.1. Pikët nga suksesi i arritur në arsimin e mesëm llogariten në këtë mënyrë:

- Mblidhen të gjitha notat, të cilat janë të evidentuara në dëftesat e notave nga të gjitha vitet, shuma e përgjithshme e fituar pjesëtohet me numrin e notave, kështu që suksesi mesatar i fituar shumëzohet me numrin 12. Me këtë më së shumti mund të fitohen 60 pikë.

a. 2. Llogaritja e pikëve të suksesit të arritur nga matura shtetërore:

- **Kandidatët me maturë shtetërore në vitin 2020/21, 2021/22, 2022/23, 2023/2024, 2024/25, maturë shtetërore ose profesionale 2025/26 dhe prej 2007/08 deri në vitin 2012/13:** rangi percentil i provimit nga dy lëndët eksterne shumëzohet me koeficient 10, ku më së shumti mund të fitohen 20 pikë të shprehur në përqindje.

- Notat e dy lëndëve interne të përshtatshme për programin studimor (Lista 2) do të shumëzohen me koeficient 1.6, ndërsa lëndët e papërshtatshme me koeficient 0.8, kështu që më së shumti nga lëndët interne të përshtatshme mund të ftohen 16 pikë, ndërsa me lëndët e papërshtatshme 8 pikë.

- Nota e fituar nga detyra e projektit shumëzohet me koeficientin 0.8, në këtë bazë mund të fitohen më shumti 4 pika.

- Pikët maksimale të mundshme nga matura shtetërore janë 40 pikë.

- **Kandidatët me maturë shtetërore prej 2013/14 deri 2018/19:** rangi percentil i provimit nga tre lëndët eksterne të përshtatshme shumëzohet me koeficient 10, ku më së shumti mund të fitohen 30 pikë të shprehur në përqindje, ndërsa lënda tretë jo e përshtatshme me koeficient 0.6:

- Nota e lëndës interne të përshtatshme për programin studimor (Lista 2) do të shumëzohen me koeficient 1.2, ndërsa lënda e papërshtatshme me koeficient 0.6, kështu që më së shumti nga lënda interne e përshtatshme mund të ftohen 6 pikë, ndërsa me lëndën e papërshtatshme 3 pikë.

- Nota e fituar nga detyra e projektit shumëzohet me koeficientin 0.8, në këtë bazë mund të fitohen më shumti 4 pika.

- Pikët maksimale të mundshme nga matura shtetërore janë 40 pikë.

- Për kandidatët të cilët shkollën e mesme e kanë mbaruar në vitet e mëparshme shkollore (para vitit shkollor 2007/2008), kandidatët me shkollim të mesëm në vitin shkollor 2019/20 që nuk kanë mbaruar maturë shtetërore dhe kandidatët me shkollim të mesëm jashtë vendit, përveç llogaritjes së pikëve nga pika 6.a.1, llogariten edhe më së shumti 40 pikë nga lëndët të cilët janë të rëndësishme për programin studimor, edhe atë: shuma e notave nga dy lëndët të rëndësishme për programin studimor dhe dy lëndët nga lëmi i gjuhëve (gjuhë amtare dhe një gjuhë botërore) pjesëtohet me 16, dhe kështu suksesi mesatar i secilës lëndë veçmas shumëzohet me 8. Në bazë të kësaj mund të fitohen më së shumti 10 pikë për një lëndë, përkatësisht 40 pikë për katër lëndë.

- **Në programet studimore ku organizohet provim pranues** (kontrolli i aftësive dhe talentit), përveç pikave të suksesit nga pika 6.a.1, 40 pikët e tjera kandidatët mund t'i fitojnë nga testi i provimit pranues. Provimi pranues ka karakter eliminimi me minimum 10 pikë, ndërsa në Fakultetin Pedagogjik me 20 pikë. Lista e programeve ku do të organizohet provim pranues është shpallur në fund të konkursit (Lista 1).

III. Seleksionimi i kandidatëve:

1. Për përcjelljen e realizimit të Konkursit, Këshilli i Rektoratit formon Komision Universitar për Konkurs;



2. Për llogaritjen e pikëve nga suksemi i arritur nga arsimit mesëm dhe nga suksemi i maturës shtetërore, Këshilli i Rektoratit formon komisione të konkursit për secilin fakultet veçmas, ndërsa programet studimore ku bëhet kontrolli i talentit, formojnë komisione edhe për kontrollimin e talentit/provimet pranuese. Komisioni Universitar i Konkursit e përcjell realizimin e Konkursit, kujdeset për respektimin e përpiktë të dispozitave të Konkursit dhe jep udhëzime dhe mendime në procesin e realizimit të tij;

3. Rangimin e kandidatëve e kryejnë komisionet e konkursit të fakulteteve, të cilat menaxhohen nga Komisioni Universitar për Konkurs;

4. Komisioni për Konkurs, në tabelat e shpalljeve të fakultetit dhe on-line e shpall rangimin sipas pikëve nga suksemi i arsimit të mesëm (suksesin mesatar), pikët e lëndëve eksterne, interne dhe nga rezultatet e kontrollimit të talentit nga programet studimore në të cilat ai zbatohet (në tabelën e rezultateve do të shpallen edhe të dhënat: numri i dosjes, emri, emri i prindit, mbiemri, vendbanimi, shtetësia, suksemi për çdo vit shkollor, pikët e fituara nga matura shtetërore, pikët e fituara dhe statusi i pranimit).

Pas shpalljes së listës preliminare të rangimit të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni për Konkurs, kandidati ka të drejtë kundërshtimi dhe ankese në afat prej 8-orëve, përmes Arkivit ose përmes formës on-line. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejshme të ankesave për rezultatet e shpallura. Kundërshtimi ka të bëjë vetëm me lëshimet teknike (gabime të bëra gjatë llogaritjes së pikëve), dhe i njëjti i drejtohet Komisionit Universitar për pranimin e studentëve.

Aktvendimi i Komisionit është përfundimtar. Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni Universitar për Konkurs në fakultetin përkatës shpall Aktvendim për pranimin e studentëve (lista përfundimtare e rangimit), në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve. Kandidatët e pranuar si dhe ata të cilët nuk janë pranuar, pas shpalljes së Aktvendimit për pranim, nuk kanë të drejtë kundërshtimi ose ankimi.

Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim nuk do të bëjnë regjistrim, respektivisht nuk do të dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim në shërbimet studentore të fakultetit në të cilin janë pranuar, konsiderohet se kanë hequr dorë nga studimet dhe vendi i tyre do të shpallet si i lirë në Konkursin e radhës;

5. Fakultetet në të cilat edhe pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit do të mbeten vende të paplotësuara, bëjnë regjistrim të studentëve në afatin e dytë dhe të tretë regjistruar. Afati i dytë dhe i tretë me vendet e lira do të shpallet vetëm në ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës: www.unite.edu.mk;

6. Nëse në afatin e parë të regjistrimit, gjatë rangimit, në fund të listës së kandidatëve të pranuar ka më shumë kandidatë me numër të barabartë të pikëve (më së shumti pesë kandidatë), fakulteti i regjistron të gjithë kandidatët e tillë. Por, nëse numri i kandidatëve të tillë është më i madh se 5 (pesë), atëherë fakulteti, kandidatët e tillë i rangon sipas kriterëve plotësues: përshtatshmëria e projekt detyrës së punuar gjatë dhënies së provimit të maturës shtetërore, çmimet e fituara në garat republikane dhe ndërkombëtare, anëtarë të reprezentacioneve sportive të Republikës së Maqedonisë së Veriut, certifikatat e fituara për njohje të gjuhëve të huaja në nivel më të lartë etj;

7. Studentët në kuotën shtetërore regjistrohen duke paguar kompensim për bashkëfinancim të studimeve, të përcaktuar si në kreun I të Konkursit në kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV-së. Kompensimi për studime të studentëve nga paragrafi paraprak, për secilin program studimor në veçanti, është pjesë përbërëse e këtij Konkursi. Pagesa e kompensimit kryhet në dy këste të barabarta. Kompensimin nga paragrafit 1 i kësaj pike, studentët e dorëzojnë për çdo semestër për aq sa zgjatim studimet e tyre me të gjitha detyrimet e tjera financiare të përcaktuara me Aktvendim nga ana e Universitetit;

8. Këshilli i Rektoratit sjell Udhëzim të veçantë për realizimin e Konkursit.

IV. Regjistrimi i studentëve me korrespondencë:

1. Në programet studimore të veçanta të fakulteteve, si studentë me korrespondencë mund të regjistrohen kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për regjistrim dhe kanë kontratë për punësim në kohë të pacaktuar, si dhe kandidatët të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mundësi të regjistrohen si studentë të rregullt. Si shkaqe të arsyeshme nga paragrafi paraprak llogariten: të qenët person invalid, i cili nuk është në gjendje ta ndjekë mësimin e rregullt; sëmundja e rëndë kronike, e cila pamundëson vijimin e rregullt të mësimit më tepër se një semestër; prind i fëmijës deri sa zgjatë pushimi i lehonisë;

2. Studentët me korrespondencë regjistrohen sipas kushteve dhe kriterëve të njëjta si studentët e rregullt, ndërsa rangohen në lista të veçanta të rangimit. Studentët me korrespondencë regjistrohen me koofinancim të studimeve, sipas shumës së paraqitur në tabelën nr. 1;

3. Gjatë paraqitjes për regjistrim, si studentë me korrespondencë, kandidatët dorëzojnë dëshmi për punësim në kohë të pacaktuar ose vërtetim mjekësor për shkaqet e theksuara në pikën 1, paragrafi 2.

V. Regjistrimi i studentëve me koofinancim të studimeve:

1. Në fakultete, si studentë të rregullt regjistrohen edhe kandidatë që i plotësojnë kushtet për regjistrim, ndërsa për shkak të kufizimit të kuotave nuk mund të regjistrohen në kategorinë e studentëve të financuar nga shteti;

2. Studentët që regjistrohen në këtë kategori, shumën e përcaktuar në kreun I të Konkursit e paguajnë në kundërvlerë të denarit, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV-së në ditën e pagesës, së paku në dy këste të barabarta;

3. Kandidatët që pajtohen të regjistrohen në këtë kategori studentësh, gjatë regjistrimit deklarojnë se pajtohen gjatë gjithë kohës së studimeve të marrin pjesë në koofinancim të studimeve ose nëse studenti i regjistron studimet sipas rezultateve të pranimit në koofinancim, konsiderohet se pranon t'i koofinancoj studimet. Listën e kandidatëve të pranuar në këtë kategori e vërteton Komisioni i Konkursit në bazë të listës së rangimit dhe deklaratave të dorëzuara për pajtueshmëri për regjistrim në këtë kategori. Studentët me koofinancim gjatë regjistrimit lidhin kontratë me fakultetin, për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në realizimin e procesit edukativo-arsimor.



VI. Kandidatët me arsim të mesëm të kryer jashtë vendit:

a) Shtetasit e huaj:

1. Shtetasit e huaj regjistrohen jashtë kuotave të përcaktuara në Konkurs dhe numri i tyre mund të jetë **20%** nga numri i përgjithshëm i studentëve të përcaktuar me konkurs në nivel të fakultetit ose programit studimor, sipas Vendimit të Komisionit Universitar për Konkurs me propozim paraprak të Komisionit të fakultetit për regjistrim;

2. Gjatë paraqitjes, kandidatët e theksojnë në cilin fakultet, respektivisht program studimor dëshirojnë të studiojnë, se a janë bursistë të qeverisë së tyre, apo vetë i bartin shpenzimet e studimeve. Me fletëparaqitje dorëzojnë diplomë për mbarimin e arsimit të mesëm, dëshminë për kryerjen e maturës shtetërore nëse e njëjta aplikohet në shtetin e tyre, si dhe dëftesa për të gjitha klasat, përkthim të vërtetuar të certifikatës së lindjes, vërtetim për njohje të gjuhës shqipe ose maqedonase (të dhënë nga Komisioni Universitar për Konkurs vetëm për kandidatët të cilët gjuhën shqipe ose maqedonase nuk e kanë gjuhë amëtare). Shtetasit e huaj, për diplomën e mbarimit të shkollës së mesme, si dhe dëftesat për të gjitha klasat, para fillimit të vitit akademik duhet të dorëzojnë Vendimin për nostrifikim nga institucioni kompetent i RMV-së, respektivisht dokumentet për fillimin e procedurës për nostrifikim. Universiteti i Tetovës organizon kurs përgatitor për mësimin e gjuhës shqipe ose maqedonase në Qendrën për gjuhë, ndërsa kandidati kryen detyrimet e duhura për ndjekjen e kursit. Pagesa e studimeve për shtetasit e huaj për vitin 2026/27 është 300 euro për një semestër respektivisht 600 euro për një vit akademik. Në programet studimore: Infermieri, Mami, Fizioterapi dhe Kozmetikë me Estetikë dhe programet studimore të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara një semestër është 500 euro, respektivisht 1000 euro për një vit akademik. Në programin studimor: Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi Dentare dhe Farmaci, pagesa e shkollimit është 1000 euro për semestër, respektivisht 2000 euro për një vit akademik, nëse nuk është rregulluar ndryshe me kontratë për bashkëpunim të ndërsjellë mes universiteteve. Në këtë kategori të studentëve bëjnë pjesë edhe kandidatët, shtetas të huaj, prindërit e të cilëve apo vetë ata punojnë në përfaqësitë diplomatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shtetasit e huaj e mbajnë statusin e njëjtë deri në diplomim.

b) Mërgimtarët dhe shtetasit e RMV-së me arsim të mesëm të kryer në tërësi dhe me arsim të mesëm të kryer pjesërisht jashtë vendit, kandidatë me maturë ndërkombëtare dhe kandidatë me shkollim të mesëm privat në RMV:

1. Kandidatët, prindërit e të cilëve janë mërgimtarë dhe kandidatët shtetas të RMV-së, që **arsimin e mesëm** e kanë kryer jashtë vendit, regjistrohen jashtë kuotave, me koefinancim të studimeve;

2. Kompensimi për studime i kësaj kategorie të studentëve, në varësi të programeve studimore, është përcaktuar në kreun I të Konkursit (si për kandidatët nga kreu V), respektivisht 400 euro për një vit akademik. Kandidatët nga pika 1, bashkë me fletëparaqitjen dorëzojnë diplomë të nostrifikuar si dhe dëftesa të nostrifikuara për katër vitet e kryera të arsimit të mesëm jashtë vendit;

3. Kandidatët shtetas të RMV-së, që një **pjesë të arsimit të mesëm** e kanë kryer jashtë vendit dhe kandidatët me maturë të mbaruar ndërkombëtare, regjistrohen me kushte dhe kriteret e njëjta, si dhe kandidatët me shkollë të mesme të mbaruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me atë që përveç dokumenteve të tjera, dorëzojnë edhe dëftesa të nostrifikuara për pjesën e arsimit të mesëm të kryer jashtë vendit, përkatësisht me maturë të kryer ndërkombëtare.

Këta kandidatë rangohen në listë të veçantë rangimi, ndërsa numri i këtyre kandidatëve mund të arrijë më së shumti **10%**.

4. Kandidatët të cilët kanë kryer shkollim të mesëm privat në RMV, të cilët kanë dhënë maturë shtetërore, regjistrohen sipas kushteve dhe kriterëve të njëjta me kandidatët që kanë kryer shkollim sipas kreut 1 të Konkursit.

VII. Kandidatët me të drejta të veçanta të përcaktuara sipas ligjeve të RMV-së si dhe kandidatët të cilët pranohen në kuadër të kuotës së bashkësive të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

1. Numri i studentëve, që i takojnë kategorisë së personave me të drejta të veçanta të përcaktuara me Ligjin për të drejta të veçanta të RMV-së, regjistrohen në kuotë të veçantë (pa bartje të shpenzimeve për studime), si: persona të moshës deri 26 vjeçare, të cilët kanë qenë pa prindër deri në moshën 18 vjeçare, nëse nuk janë të punësuar, persona me invaliditet (Vlerësim profesional nga ISHP - Shkup dhe me vendim të Qendrës për Punë Sociale për llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar), invalid lufte, persona të papunë të rritur në shtëpitë e fëmijëve të braktisur; prind i fëmijës të moshës deri 6 vjeçare, ku numri i tyre mund të arrijë më së shumti 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve në nivel të programit studimor;

2. Për sigurimin e përfaqësimit të drejtë të kandidatëve të cilët u takojnë bashkësive të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në institucionet e larta të universitetare, në vitin akademik 2026/27, në mënyrë plotësuese do të regjistrohen kandidatët të cilët u takojnë këtyre bashkësive, numri i të cilëve nuk e kalon **10%** nga numri i përgjithshëm i studentëve të cilët regjistrohen në vitin e parë në nivel të fakultetit. Në kuadër të kësaj përqindjeje, në mënyrë të drejtë do të përfaqësohen kandidatët e të gjitha bashkësive, deri në përqindjen me të cilën bashkësia përkatëse është përfaqësuar në numrin e përgjithshëm të banorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Mjetet e participimit për këta kandidatë do të mbulohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.



VIII. Afatet për paraqitje, kontrollimin i njohurive dhe aftësive dhe regjistrimi

REALIZIMI I KONKURSI PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE - 2026/27	AFATI I	AFATI II	Afati III
Aplikimi (dorëzimi i dokumenteve në administratë)	24 - 28.08.2026	07 - 11.09.2026	21-22.09.2026
Kontrolli i njohurive dhe aftësive (provim pranues për programet dhe kategoritë e caktuara sipas listës 1)	29.08.2026	12.09.2026	23.09.2026
Shpallja e rezultateve preliminare dhe afati i ankesave	31.08.2026	14.09.2026	24.09.2026
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	01.09.2026	15.09.2026	25.09.2026
Regjistrimi i kandidatëve	01- 04.09 2026	15-18.09.2026	25 - 29.09.2026

IX. Dokumentet për aplikim dhe regjistrim:

1. Kandidatët e plotësojnë formularin online në ueb faqen: apply.unite.edu.mk. Pas aplikimit në sistemin elektronik, kandidatët duhet që dokumentet t'i dorëzojnë në administratë brenda afatit të caktuar:

A. Pas aplikimit on-line, në emailin e tyre kandidatët pranojnë konfirmim dhe link për aktivizimin e profilit të aplikuesit, prej ku i përcjellin të gjitha fazat e shqyrtimit të dokumenteve, rangimit, rezultateve dhe regjistrimit;

B. Profili i aplikimit mund përdoret edhe për aplikim në afatin e dytë ose tretë;

2. Gjatë plotësimit të formularit, kandidatët dokumentet duhet t'i bashkangjesin (attach) të skenuara ose si fotografi (skenimi ose fotografite duhet të jenë të lexueshme dhe ta përfshijnë dokumentin e plotë me të gjitha të dhënat në të dy anët e fletës);

3. Dëftesat origjinale nga shkollimi i mesëm;

4. Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme;

5. Certifikatë nga libri amzë i të lindurve;

6. Certifikatë shtetësie;

7. Dëshmi (fletëpagesë) për pagesat:

a) **1050 denarë** në xhirollogarinë e Universitetit në emër të taksave administrative.

b) **600 denarë** për mjete plotësuese për secilën lëndë në të cilën kandidatët do të nënshtrohen për provim pranues, të theksuar në Listën shitesë 1, të programit studimor përkatës, ku është paraparë provimi pranues: në emër të Komisionit për verifikimin e njohurive dhe aftësive dhe intervistimit (për programet në gjuhën angleze).

Kandidatët që aplikojnë në programet ku mundësohen studime me korrespondencë, krahas dokumentacionit të caktuar më lart, duhet të dorëzojnë dokumentet përkatëse për arsyetimin e këtij statusi sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Konkurs. Kandidatët të cilët aplikojnë në bazë të kuotës së veçantë, dorëzojnë dokumentet të cilat dëshmojnë kategorinë përkatëse.

Kandidatët të cilët janë të pranuar (**pas shpalljes së listës përfundimtare**), regjistrimin e semestrit të parë e realizojnë përmes kycjes në profilin elektronik të aplikimit, duke shtypur REGJISTRO SEMESTRIN dhe më pas në administratë duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (Fletëparaqitja lëshohet nga administrata duke e shkarkuar nga sistemi elektronik);

2. Tri fotografi (dy fotografi 6x9 cm dhe një fotografi 4x5cm);

3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:

- **100 denarë**, në emër të Kuvendit studentor
- **1200 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Index-it.
- **750 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit.
- **Pagesën e mjeteve për semestrin e parë sipas tarifave të përcaktuara në kreun I të konkursit**

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhirollogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

Pagesa prej Maqedonisë së Veriut online: <https://epay.unite.edu.mk/> ose

- Pagesat mund të bëhen edhe përmes aplikacioneve elektronike bankare me formular **PP50** ose me fletëpagesë në bankë/postë;
- Fletëpagesa qoftë përmes aplikacionit ose fletëpagesës në bankë, duhet të figurojë në **emër të studentit**;
 - ❖ Në emri i marrësit (**назив на примачот**) - Universiteti i Tetovës,
 - ❖ Në „banka e marrësit“ (**банка на примач**) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
 - ❖ Në „llogaria“ (**сметка**) – **100000000063095**,
 - ❖ Në „shuma“ (**износ**) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhet,



- ❖ Në „llogaria e shfrytëzuesit buxhetor - subjekti shfrytëzues” (сметка на буџетски корисник – единка корисник” – **1600160054 788 10**;
- ❖ në „shifra dhe programi i të hyrave” (приходна шифра и програма) – **723019 43**, ndërsa në „mënyra” (начин) – **2**;
- ❖ Në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (цел на дознака) – qëllimi i pagesës (aplikim, semestri, indeks, provim pranues etj.).
 - o Në rast se pagesat përmes aplikacioneve bankare i kryen person tjetër për studentin e caktuar, në këtë rubrikë ((цел на дознака) – qëllimi i pagesës)), e shënon edhe emrin e studentit për të cilin e kryen pagesën (shembull: aplikim:Emri dhe Mbiemri)

Pagesa prej jashtë shtetit: <https://epay.unite.edu.mk/>
NATIONAL BANK OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA
NAME: UNIVERZITET VO TETOVO
IBAN: MK07 1007 0100 0066 227
SWIFT BIC: NBRM MK 2X

Konkursi është shpallur në faqen e internetit: <http://www.unite.edu.mk>



Lista 1. Programet studimore në të cilat përveç zgjedhjes së lëndëve interne adekuate të dhëna në listën nr. 2, për shkak të specifikave të studimit kryhet kontrollimi i talentit dhe njohurive:			
Programi studimor	Provimi pranues	Kandidatët që duhet të marrin pjesë	Orari dhe vendi
Mjekësi e Përgjithshme Mjekësi Dentare Farmaci	A. Biologji B. Kimi (Njohuri të fituara nga arsimi i mesëm)	Shtetas të huaj; Kandidatët me shkollim të mesëm jashtë RMV-së; Kandidatët të cilët nuk kanë dhënë maturë shtetërore; Kandidatët me maturë shtetërore të cilët në lëndët eksterne dhe interne nuk kanë dhënë biologji dhe kimi (ose lëndë profesionale nga fusha e mjekësisë);	29 gusht 2026 11 ⁰⁰ h Rektorati i UT-së
Kulturë Fizike dhe Shëndetësi	A. Futboll, hendboll, basketboll, volejball, gjimnastika sportive, atletikë	Të gjithë kandidatët Kandidatët me vete duhet të marrin përgatitje sportive	29 gusht 2026 9 ⁰⁰ h Fakulteti i Kulturës Fizike
Trajner i Sportit - Futboll	A. Futboll	Të gjithë kandidatët Kandidatët me vete duhet të marrin përgatitje sportive	29 gusht 2026 900 h Fakulteti i Kulturës Fizike
Trajner i Sportit - Basketboll	A. Basketboll	Të gjithë kandidatët Kandidatët me vete duhet të marrin përgatitje sportive	29 gusht 2026 900 h Fakulteti i Kulturës Fizike
Trajner i Sportit - Volejball	A. Volejball	Të gjithë kandidatët Kandidatët me vete duhet të marrin përgatitje sportive	29 gusht 2026 900 h Fakulteti i Kulturës Fizike
Trajner i Sportit - Sportet Mundëse	A. Sporte mundëse	Të gjithë kandidatët Kandidatët me vete duhet të marrin përgatitje sportive	29 gusht 2026 900 h Fakulteti i Kulturës Fizike
Arkitekturë	A. Vizatim - kreacion i lirë i objekteve	Të gjithë kandidatët	29 gusht 2026 10 ⁰⁰ h Fakulteti i Shkencave të Zbatuara
Edukim Parashkollor Mësim Klasor	A. Testim i aftësive intelektuale, test i inteligjencës joverbale, intervistë e strukturuar për aftësitë e komunikimit; B. Testimi i lëvizjeve motorike.	Të gjithë kandidatët Kandidatët me vete duhet të marrin përgatitje sportive	29 gusht 2026 09 ³⁰ h Fakulteti Pedagogjik
Art Figurativ - Pedagogji Figurative	A. Vizatim - portret me model të gjallë, B. Vizatim - figura e njeriut me model të gjallë (Mjetet dhe materialet e nevojshme për pjesën e parë dhe të dytë: letër ose pag në formatin B1 70x100 cm, laps B6 (i butë) ose qymyr-thëngjill, gomë), C. Pikturë - natyrë e vdekur, në një nga teknikat e pikturës (Mjetet dhe materialet e	Të gjithë kandidatët	29 gusht 2026 10 ⁰⁰ h Në hapësirat e programeve studimore



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT | РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
UNIVERSITETI I TETOVËS | УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО
www.unite.edu.mk, e-mail: zyraperarsim@unite.edu.mk, Tetovë, 1200,



	<i>nevojshme: kanavacë në kornizë për pikturë ose letër hamer formati B2 50x70 cm, bojra, brusha, paletë).</i>		
Art Figurativ - Pikturë	A. Vizatim - portret me model të gjallë, B. Vizatim - figura e njeriut me model të gjallë, <i>(Mjetet dhe materialet e nevojshme për pjesën e parë dhe të dytë: letër ose pag në formatin B1 70x100 cm, laps B6 (i butë) ose qymyr-thëngjill, gomë),</i> C. Pikturë - natyrë e vdekur, në një nga teknikat e pikturës, <i>(Mjetet dhe materialet e nevojshme: kanavacë në kornizë për pikturë ose letër hamer formati B2 50x70 cm, bojra, brusha, paletë).</i>	Të gjithë kandidatët	29 gusht 2026 10⁰⁰ h Në hapësirat e programeve studimore
Art Figurativ - Skulpturë	A. Vizatim - portret me model të gjallë, B. Vizatim - figura e njeriut me model të gjallë <i>(Mjetet dhe materialet e nevojshme për pjesën e parë dhe të dytë: letër ose pag në formatin B1 70x100 cm, laps B6 (i butë) ose qymyr-thëngjill, gomë),</i> C. Modelimi - portret në argjilë <i>(Mjetet dhe materialet e nevojshme sigurohen nga vetë Fakulteti).</i>	Të gjithë kandidatët	29 gusht 2026 10⁰⁰ h Në hapësirat e programeve studimore
Art Figurativ - Grafikë	A. Vizatim - portret me model të gjallë, B. Vizatim - figura e njeriut me model të gjallë <i>(Mjetet dhe materialet e nevojshme për pjesën e parë dhe të dytë: letër ose pag në formatin B1 70x100 cm, laps B6 (i butë) ose qymyr-thëngjill, gomë),</i> C. Vizatim - natyrë e vdekur, në një nga teknikat e vizatimit, <i>(Mjetet dhe materialet e nevojshme: letër hamer formati B3 50x35 cm, tush, pendë, brusha, paletë).</i>	Të gjithë kandidatët	29 gusht 2026 10⁰⁰ h Në hapësirat e programeve studimore
Art Figurativ - Dizajn Grafik	A. Vizatim - portret me model të gjallë, B. Vizatim - figura e njeriut me model të gjallë <i>(Mjetet dhe materialet e nevojshme për pjesën e parë dhe të dytë: letër ose pag në formatin B1 70x100 cm, laps B6 (i butë) ose qymyr-thëngjill, gomë),</i> C. Ilustrim - i një tregimi të lexuar <i>(Mjetet dhe materialet e nevojshme: letër hamer formati B3 50x35 cm, lapsa me ngjyra, follmaster, bojra akuareli ose temera, paletë).</i>	Të gjithë kandidatët	29 gusht 2026 10⁰⁰ h Në hapësirat e programeve studimore
Art Muzikor - Pedagogji Muzikore	A. Solfezh: Diktat një zanor, dëgjime të intervaleve dhe akordeve, këndim prima vista. B. Harmoni: Pyetje teorike nga lënda e harmonisë, detyrë në bas(deri te alteracioni i dominantës së dyfishtë) C. Piano: Një vepër nga J.S.Bah, Etydë, Pjesë e lirë, një kohë të parë të ciklit të sonatës	Të gjithë kandidatët	29 gusht 2026 10⁰⁰ h Në hapësirat e programeve studimore
Art Muzikor - drejtimi Muzikologji	A. Solfezh: Diktat një zanor, dëgjime të intervaleve dhe akordeve, këndim prima vista B. Harmoni: Pyetje teorike nga lënda e harmonisë, detyrë në bas(deri te alteracioni i dominantës së dyfishtë) C. Muzikologji: a) Punë që duhet të paraqiten: Një recenzion, një përkthim, një analizë të një vepre muzikore, b) Punë në klasë: Një ese mbi një temë të caktuar	Të gjithë kandidatët	29 gusht 2026 10⁰⁰ h Në hapësirat e programeve studimore
Art Muzikor - Solo Këndim	A. Solfezh: Diktat një zanor, dëgjime të intervaleve dhe akordeve, këndim prima vista, B. Harmoni: Pyetje teorike nga lënda e harmonisë, detyrë në bas(deri te alteracioni i dominantës së dyfishtë) C. Solo këndim: Një arie antike, një arie, një pjesë e lirë	Të gjithë kandidatët	29 gusht 2026 10⁰⁰ h Në hapësirat e programeve studimore

Kandidatët duhet të kenë me vete dokument identifikimi.



Lista 2. Lëndët interne dhe eksterne të përshtatshme për regjistrim

Fakulteti	Lëndë eksterne dhe interne të përshtatshme	
Fakulteti Ekonomik	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Gjuhë e huaj, informatikë, matematikë, biznes, varësisht lëndëve eksterne. Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar.
Fakulteti Juridik	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Gjuhë e huaj, matematikë, histori, filozofi, estetikë, sociologji, biznes, filozofi varësisht lëndëve eksterne. Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar.
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Informatikë, matematikë, biologji, kimi ose një lëndë nga fusha e shkencave natyrore, varësisht lëndëve eksterne. Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar.
Fakulteti i Shkencave Mjekësore	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	<i>Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi Dentare, Farmaci:</i> Kimi, biologji. Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e shëndetësisë. <i>Infermieri, Akushi, Fizioterapi:</i> Informatikë, biologji, kimi, gjuhë e huaj, varësisht lëndës eksterne. Lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale nga profili i arsimit.
Fakulteti Filologjik	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Gjuhë e huaj, informatikë, matematikë, sociologji, filozofi, varësisht lëndëve eksterne. Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar.
Fakulteti Filozofik	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Informatikë, matematikë, biologji, sociologji, histori, gjuhë e huaj, filozofi, estetikë, varësisht lëndëve eksterne. Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar.
Fakulteti i Arteve	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Pa kufizim
Fakulteti i Kulturës fizike	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Pa kufizim
Fakulteti i Shkencave të Zbatuara	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	<i>Arkitekturë:</i> pa kufizim <i>Programet tjera studimore:</i> Informatikë, matematikë, kimi, fizikë, estetikë, gjuhë e huaj, varësisht lëndëve eksterne. Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar.
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Informatikë, biologji, matematikë, gjuhë e huaj, kimi, fizikë, varësisht lëndëve eksterne. Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar.
Fakulteti i Administrimit të Biznesit - Kumanovë	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Gjuhë e huaj, matematikë, informatikë, filozofi, biznes, sociologji, varësisht lëndëve eksterne. Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar.
Fakulteti Pedagogjik	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Pa kufizim
Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë	Gjimnaz Shkollë profesionale Shkolla e mesme artistike	Informatikë, matematikë, biologji, gjuhë e huaj, kimi ose një lëndë nga fusha e shkencave natyrore varësisht lëndëve eksterne. Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar.



Për të gjitha fakultetet dhe programet studimore, lëndën e dytë interne, respektivisht lëndën interne, maturanti e zgjedh nga lista e lëndëve profesionale në varshmëri prej profilit të përgatitjes arsimore të kandidatit.

Lista 3. Lista e përshtatshmërisë së profesioneve/sectorëve dhe profileve/kualifikimeve me fushat sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED-F 2013) për kandidatët që kanë kryer maturën shtetërore profesionale/artistike në vitin akademik 2025/2026, dhe që janë të përshtatshëm për aplikim dhe regjistrim në programet e studimit në Universitetin e Tetovës

Lista është e publikuar në ueb faqen www.unite.edu.mk/apply